



**Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus +
në "Gh. Asachi" Technical University of Iasi, në Rumani.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në "Gh. Asachi" Technical University of Iasi, Rumani.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime;
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime;
- Shkëmbimin e stafit për mësimdhënie.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës);
- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës);
- **Staff për mësimdhënie.**

Kohëzgjatja e bursave:

- 3.25 muaj, për studentët
- 7 ditë, për stafin

Fusha e studimit: Arkitekturë dhe Urbanistikë

Numri total i studentëve: 2

Numri total i stafit për mësimdhënie: 1



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Dokumenti Staff Mobility for Teaching Mobility Agreement;
- Niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B2. (Anglisht).

**ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për gjuhën angleze duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në "Gh. Asachi" Technical University of Iasi lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni si më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

Studentët e nominuar nga UPT, pas nominimit, duhet të aplikojnë përmes platformës elektronike të "Gh. Asachi" Technical University, në linkun:

<https://www.erasmus-application.tuiasi.ro/agreement.php>

Për të parë listën e lëndëve që do të zhvillohen në "Gh. Asachi" Technical University, klikoni në linkun:

www.study-programmes.tuiasi.ro/search.php?q=architecture

Formulari për akomodim gjatë periudhës së mobilitetit për studentët gjendet në linkun:

[TUIASI_AccommodationForm.pdf](#)

Afati për aplikim për studentët: Deri më 22 Qershor 2021

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al